



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT  
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKT VENDIM**

**MBI MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR  
AFATMESEM 2023-2025**

Këshilli Bashkiak Berat, pasi u njoh me materialin “Mbi miratimin e tavaneve përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”, mbështetur në Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndyshuar , Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore ”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 7 datë 25.02.2022 “ Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore ”, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë:

1.1 Planin financiar të Bashkisë Berat për periudhën afatmesme 2023-2025 sipas pasqyrave bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij p/vendimi.

1.2 Tavanet përgatitore të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 sipas pasqyrës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij p/vendimi.

2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhimin Strategjik.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ervin CECA**

